

Nr. Prot. 0xx/B/19

Nr. i Regjistrimit: xxxx

## RREGULLORE

### PËR

### 'AUTORIZIMIN E PËRGJITHSHËM'

### PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE

#### KAPITULLI I

#### Baza Ligjore, Qëllimi dhe Fushëveprimi, Termat dhe Përkufizimet

##### Neni 1

##### Baza Ligjore

- (1) Kjo Rregullore është nxjerrë në bazë të nenit 4 paragrafi 1), nenit 7 paragrafi 2.1) dhe paragrafi 2.2), nenit 16 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 3.1), nenit 20, nenit 21, dhe 22, të Ligjit Nr. 06/L-38, për Shërbime Postare, (tutje referuar si: Ligji), nenit 10 paragrafi 2.1) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në përputhshmëri me Direktivën 97/67, KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 Dhjetor 1997, për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimit postar të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, e ndryshuar me Direktivën 2002/39, KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 Qershor 2002, dhe Direktivën 2008/6, KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian datë 20 Shkurt 2008.

##### Neni 2

##### Qëllimi dhe fushëveprimi

- (1) Qëllimi i kësaj Rregullore, është vendosja e rregullave, përcaktimi i procedurave dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve postare, në Republikën e Kosovës, nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', e që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.
- (2) Kjo Rregullore, zbatohet nga të gjitha ndërmarrjet, të cilat dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare për qëllime fitimi, në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe Rregulloren për 'Autorizimit të Përgjithshëm', për ofrimin e shërbimeve postare, të miratuar nga Autoriteti

Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si: Autoriteti*) dhe aktet tjera në zbatim të saj.

### Neni 3 Termet dhe Përkufizimet

(1) Për qëllim të kësaj Rregulloreje;

1.1. Kuptimi apo definicioni i secilës fjalë, frazë apo shprehje, sipas Ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore.

1.2. Shprehjet, frazat, dhe shkurtesat e mëposhtme do të kenë kuptimin si në vijim:

- a) **Autorizim i përgjithshëm** – akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga korniza ligjore, e përcaktuar nga Ligji dhe rregullat e nxjerra nga Autoriteti, në zbatim të tij, me anë të të cilit një ofruesi të shërbimit postar i jepet e drejta për ofrimin e shërbimeve postare përveç shërbimeve universale dhe te rezervuara postare;
- b) **Adresa** – çdo grup shenjash në një dërgesë postare që tregojnë adresën e marrësit dhe pikën e dorëzimit të dërgesës postare. Adresimi i dërgesave postare do të rregullohet më hollësisht në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve postare;
- c) **Kod postar** – është një mjet identifikues dhe element themelor i një adrese postare, dhe përmban informacionin e nevojshëm për dërgimin e dërgesës postare deri në dorëzimin e saj. Ai është i përbërë nga 6 karaktere numerike;
- d) **Zyrë postare** – është një ambient biznesi i cili përdoret nga ofruesi i shërbimit postar apo nënkontraktorët e tij për të ofruar shërbimet postare;
- e) **Ofruesi i shërbimit postar** – personi fizik ose juridik që ofron një ose më shumë
- f) shërbime postare
- g) **Postë direkte** – janë dërgesa postare të natyrës komerciale, që i dërgohen një numri të madh klientësh të mundshëm nëpërmjet postës në të njëjtën kohë;
- h) **Postë hibride** – është një shërbim postar me bazë elektronike, nëpërmjet të cilit dërguesi e poston mesazhin në formë fizike ose elektronike, i cili më pas përpunohet në mënyrë elektronike dhe shndërrohet në dërgesë postare për t’u dërguar fizikisht tek marrësi;
- i) **Postë me shumicë** – është posta që konsiston në dërgimin e një sasive të madhe dërgesash postare identike (letra të së njëjtës natyrë ose reklama) që dërgohen në adresa individuale me çmim më të lire se tarifatat standarde, për të cilat pagesa kryhet në total;
- j) Shërbime postare – shërbimet me pagesë që përfshijnë pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare në rrjetin postar kombëtar dhe ndërkombëtar;
- k) **Shërbimi i shkëmbimit të dokumenteve** – Shërbimi që ofron mjetet (facilitetet), duke përfshirë ofrimin e ambijenteve për depozitim nga ana e dërguesit dhe marrjen nga ana e të adresuarit, të dy të abonuar për të realizuar këtë shërbim të dërgesave postare;
- l) **Dokument shoqërues i dërgesës postare** – është dokument që shoqëron një dërgesë postare nga pranimi deri në dorëzimin e saj. Gjithashtu si term i njohur është emërtimi ‘Fature (Fletë) Shoqëruese’ ndërsa ndërkombëtarisht është ‘Way Bill’ ose ‘Air Way

Bill', shkurtimisht AWB. Ky dokument përmban të dhënat e kërkuara e që ndërlihdën me dërgesën postare. Përgjegjësi për plotësimin korrekt të këtij dokumenti është dërguesi.

- m) **Termt dhe kushtet e përgjithshme të transportit** – ofruesi i shërbimit postar, në termt dhe kushtet e përgjithshme të transportit përcaktohen rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesit, si referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur dërgesa postare nuk mund të dorëzohet në destinacionin e mbërritur. Përcakton rregullat e inspektimit të dërgesës postare, mënyra e llogaritjes së pagesës për transportin, si edhe përgjegjësitë dhe limitet e përgjegjësisë të ofruesit të shërbimit postar;
- n) **CEN** – Komiteti Evropian i Standardizimit.
- o) **AKS** – Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) e Republikës së Kosovës;
- p) **Ligji** – Ligji Nr. 06/L-38, për shërbime postare i datës 21/12/2018;
- q) **Autoriteti** – Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

## KAPITULLI II

### SHËRBIMET POSTARE, AKTIVITETET DHE LLOJET E DËRGESAT POSTARE

#### Neni 4

##### Shërbimet postare, aktivitetet të cilat Njoftohen

- (1) Shërbimet postare që ofrohen jashtë kushteve të ofrimit të shërbimit universal postar, për të cilat duhet të Njoftohet Autoriteti, sipas kësaj Rregullore, janë paraqitur si në vijim:

- 1.1 Shërbimi i pranimit, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të dërgesave postare të postës së shpejtë - Postë Ekspres, brenda dhe jashtë vendit;
- 1.2 Shërbimi i pranimit, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të dërgesave postare, postës jo të shpejtë – Jo Ekspres, brenda dhe jashtë vendit;
- 1.3 Shërbimi i shpërndarjes së dërgesave të paadresuara për publicitet ose Reklama;
- 1.4 Shërbimi i shkëmbimit të dokumenteve;
- 1.5 Shërbimi i dorëzimit të dërgesave postare me shumicë;
- 1.6 Shërbimi i postës hibride;
- 1.7 Shërbimi i postës direkte;
- 1.8 Të tjera.

#### Neni 5

##### Llojet e dërgesave postare

- (1) Llojet e dërgesat postare, kur personat fizik ose juridik të interesuar dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare, të cilat nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, përfshijnë:

- 1.1 dërgesat e korrespondencës,
- 1.2 pakot postare,
- 1.3 dërgesat e regjistruara,
- 1.4 dërgesat e siguruara;

- 1.5 dokumenta biznesi;
- 1.6 libra;
- 1.7 katalogë;
- 1.8 gazeta;
- 1.9 revista; dhe
- 1.10 mallra me ose pa vlerë tregtare.

## **Neni 6**

### **Karakteristikat e dërgesave postare**

- (1) Karakteristikat e dërgesave postare përfshijnë dimensionet, përmbajtjen, adresimin, paketimin dhe mbylljen.
- (2) Dërgesa e korrespondencës përmbajnë materiale të shkruara ose të shtypura, ndërsa pakot postare përmbajnë mallra.
- (3) Paketimi i dërgesave postare nënkupton vendosjen e përmbajtjes së dërgesës postare në një paketim të duhur, në përputhje me përmbajtjen e dërgesës postare, llojin e shërbimit të zgjedhur, kushtet dhe kohëzgjatjen e transportit. Dërguesi është përgjegjës për paketimin e përshtatshëm të dërgesave postare.
- (4) Mbyllja e dërgesave postare duhet të jetë e tillë, që të mbrojë konfidencialitetin e përmbajtjes së dërgesës postare dhe të parandalojë qasjen në përmbajtjen e dërgesës pa e dëmtuar dukshëm paketimin. Dërguesi është përgjegjës për mbylljen e dërgesave postare.
- (5) Adresa është informacioni që tregon qartë marrësin e dërgesave postare. Adresimi i dërgesave postare do të thotë vendosja e adresës së marrësit në dërgesën postare ose në dokumentin shoqërues të dërgesës postare. Në rast të dërgesave postare që kërkojnë vërtetim/dokument të pranimit, dërguesi duhet të vendosë adresën e tij/saj në dërgesën postare në mënyrë të tillë që të mos mund të fshihet pa lënë gjurmë të dukshme në dërgesën postare. Dërguesi është përgjegjës për vendosjen e adresës së marrësit në mënyrë të qartë në dërgesat postare apo në dokumentin shoqërues të dërgesës postare. Dërguesi është përgjegjës për plotësimin e rregullt të dokumentacionit të kërkuar konform rregullave të transportit ndërkombëtar.
- (6) Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar të publikuara prej tij, duhet të përcaktojë karakteristikat e dërgesave postare që do të pranohen për transport, mallrat të papranueshme për transport, si dhe përgjegjësitë.
- (7) Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme të transportit duhet të përcaktojë karakteristikat e dërgesave postare për transport ndërkombëtar, rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesi referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur dërgesa postare nuk mund të dorezohet në destinacionin e mbërritur, si edhe përgjegjësitë.
- (8) Ofrimi i shërbimeve postare bëhet në përputhje me standardet e harmonizuara europiane dhe standardet ndërkombëtare për shërbimet postare, të përcaktuara nga UPU-ja, dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar për transportin e dërgesave postare.

## **KAPITULLI III**

Faqe 4 nga 21

---

Adresa: rr. Bedri Pejani nr. 23, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 212-345; Fax: + 383 38 212 399;

E-mail: [info@arkep-rks.org](mailto:info@arkep-rks.org); web-site: [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org)

## PROCEDURA E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

### Neni 7

#### Autorizimi i Përgjithshëm

- (1) E drejta për të ofruar shërbime postare në Republikën e Kosovës, kur ofrimi i shërbimeve postare bëhet jashtë kushteve të shërbimit universal postar, bëhet përmes 'Autorizimit të Përgjithshëm', me 'Njoftim'.
- (2) 'Autorizimi i Përgjithshëm', përcakton dhe vendos kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare, ashtu si paraparë në Shtojcën III, të kësaj Rregullore, e që duhet ti respektojë çdo ndërmarrës apo sipërmarrës që dëshiron të ofrojë shërbime postare. 'Autorizimi i Përgjithshëm' mbulon të gjitha proceset ose pjesë të proceseve të pranimit, përpunimit, transportit, shpërndarjes dhe dorëzimit të dërgesave postare.

### Neni 8

#### Procedura e Njoftimit

- (1) Për të ofruar shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit, personi/at fizik ose juridik të intersuar duhet që të kryejnë procedurën e Njoftimit duke plotësuar një formular aplikimi; 'Njoftim Regjistrimi', sipas formatit të specifikuar dhe bashkëngjitur në Shtojcën I, të kësaj Rregullore.
- (2) Personi fizik dhe/ose personi juridik para se të kryejë procedurën e njoftimit te Autoriteti duhet të regjistrojë biznesin për aktivitetin e shërbimeve postare në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- (3) Njoftimi i Regjistrimit paraqitet në Autoritet, duke plotësuar online formularin e 'Njoftim regjistrimit', në platformën elektronike tek moduli i aplikimit për 'Autorizim të Përgjithshëm' në ueb faqen e Autoritetit, [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org), në përputhje me modelin e 'Njoftimit të Regjistrimit', të përfshirë në Shtojcën I, të kësaj Rregullore.
- (4) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të plotë dhe të saktë, Autoriteti, regjistron ofruesin e shërbimit në bazën elektronike të të dhënave, dhe i konfirmon atij, me shkrim, kryerjen e regjistrimit. Nëse Autoriteti, nuk konfirmon, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, ose nuk informon personin fizik ose juridik për plotësimin e informacionit të munguar, njoftimi vlerësohet i plotë dhe regjistrimi përkatës quhet i përfunduar.
- (5) Kur informacioni për regjistrimin e një njoftimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligj dhe këtë Rregullore, Autoriteti brenda pesëmbëdhjetë (15) dite, nga dita e aplikimit online, njofton të interesuarin për nevojën e plotësimit/saktësimin të informacionit/ve. I interesuari duhet të paraqesë duke plotësuar tek moduli i aplikimit online 'Njoftimin e Regjistrimit', të plotë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e njoftimit të Autoriteti. Nëse personi fizik ose juridik nuk e plotëson informacionin e munguar, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, Autoriteti, e informon personin në formë

elektronike se nuk do ta regjistrojë. Personi fizik ose juridik ka të drejtë të ankohet pranë Autoritetit, për këtë çështje brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit.

- (6) Personi fizik ose juridik i cili ka depozituar në Autoritet, një 'Njoftim Regjistrimi' të rregullt dhe të plotë, përmes formës online dhe është pajisur me një certifikatë konfirmimi nga Autoriteti, ka të drejtë të ushtrojë vetëm aktivitet-in/et e përcaktuara në certifikatën e konfirmimit të Njoftimit të lëshuar nga Autoriteti.
- (7) Autoriteti nuk do t'i ngarkojë ndërmarrësit me asnjë kosto financiare për procedurën e njoftimit.
- (8) Ofruesit e shërbimeve postare që operojnë nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', janë të detyruar të njoftojnë Autoritetin, sipas të njëjtës procedurë, për çdo ndryshim kur:
  - 6.1 kërkohet të ofrohen shërbime postare të tjera, përveç atyre të deklaruara në 'Njoftimin e Regjistrimit' fillestar;
  - 6.2 kërkohet të mbyllë një ose disa shërbimet postare të vendosura më parë në 'Njoftimin e Regjistrimit' dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore;
  - 6.3 ka pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor, duke dërguar bashkëngjitur dokumentat që vertetojnë keto ndryshime;
  - 6.4 bëhet ndonjë ndryshim në detaje të 'Njoftimit të Regjistrimit'.
- (9) Çdo ndryshim në të dhënat, Autoriteti duhet të njoftohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga ndodhja e tyre.
- (10) Formulari 'Njoftimi i Regjistrimit', i plotësuar sipas paragrafit 2, të këtij neni, nënshkruhet nga ofruesi i shërbimeve postare në momentin e tërheqjes së certifikates së 'Konfirmimit të Njoftimit' dhe arkivohet në Autoritet, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- (11) Nëse ofruesi i shërbimeve postare, brenda tridhjetë (30) ditë, nga njoftimi i Autoritetit, nuk tërheq certifikatën e 'Konfirmimit të Njoftimit', Autoriteti, ka të drejtën e kryerjes së procedurës së çregjistrimit të sipërmarrësit nga regjistri.

## Neni 9

### Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit

- (1) Certifikata e konfirmimit të njoftimit vërteton se:
  - 1.1 ofruesi i shërbimeve postare ka plotësuar një 'Njoftim Regjistrimi' në formatin e duhur;
  - 1.2 ofruesi i shërbimeve postare do të ofrojë shërbime postare sipas zërave të plotësuar në 'Njoftimin e Regjistrimit', të konfirmuara nga Autoriteti;
- (2) Forma dhe përmbajtja e certifikatës së 'Konfirmimit të Njoftimit' përcaktohet sipas **Shtojcës II**, të kësaj Rregullore. Certifikata do të printohet në dy kopje, një për ofruesin e shërbimeve postare dhe një kopje për Autoritetin.



- (3) Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit do të lëshohet me afat të pacaktuar, përveç nëse Autoriteti vendos ndryshe me vendim të veçantë

#### **Neni 10**

##### **Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Postare**

- (1) Autoriteti, administron një regjistër të përditësuar të ofruesve të shërbimeve postare, përmes një baze të të dhënave në të cilën ruhet informacionet e ndërmarrësve. Regjistri i ndërmarrësve - ofruesve të shërbimeve postare, duhet të përmbajë këto të dhëna:
- 1.1 emrin dhe adresën e ndërmarrësit;
  - 1.2 të dhënat e regjistrimit të biznesit;
  - 1.3 përshkrimin e shkurtër të shërbimit/eve dhe/ose rrjetit postar;
  - 1.4 deklarin e zonës së ofrimit të shërbimeve postare;
  - 1.5 data e lëshimit të certifikatës;
  - 1.6 data e fillimit të aktiviteteve; dhe
  - 1.7 personat e kontaktit.

#### **Neni 11**

##### **Ndryshimi i autorizimit të përgjithshëm**

- (1) Autoriteti, me vendim të veçantë mundë të ndryshoj të drejtat, kushtet dhe procedurat për 'Autorizimin e Përgjithshëm', në rastet kur janë objektivisht të justifikuara sipas përcaktimeve të nenit 22, të Ligjit.

#### **Neni 12**

##### **Detyrimet e ofruesit të shërbimeve postare**

- (1) Ofruesit e shërbimeve postare të cilat ofrojnë shërbime postare janë të detyruara që t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare të specifikuar në Shtojcën III, të kësaj rregullore.
- (2) Ofruesit e shërbimeve postare, të cilët ofrojnë shërbime postare nuk duhet të tejkalojnë deklarinimet e bëra në 'Njoftimin e Regjistrimit', ose kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare, dispozitat e kësaj Rregullore si dhe aktet e tjera që ndërlidhën me ofrimin e shërbimeve postare.
- (3) Në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, ofruesit e shërbimeve postare, janë të detyruar që të dërgojnë pranë Autoritetit të dhënat dhe raportet periodike për veprimtarinë e tyre.
- (4) Të gjithë ofruesit e shërbimeve postare, të cilët operojnë nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', duhet të kryejnë të gjitha obligimet financiare ndaj Autoritetit, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe Rregulloret e miratuara nga Autoriteti.

- (5) Nëse ofruesi i shërbimeve postare i cili ofron shërbime postare nuk vepron në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, atëherë Autoriteti do të veprojë në përputhje me nenin 58, të Ligjit dhe rregullores të miratuar nga Autoriteti mbi sanksionet ekonomike.

### **Neni 13**

#### **Mbyllja e veprimtarisë**

- (1) Kur ofruesi i shërbimeve postare vendos të mbyll veprimtarinë e njoftuar dhe të regjistruar në Autoritet, ai është i detyruar të njoftojë Autoritetin të paktën tridhjetë (30) ditë, para fillimit të procedurave ligjore të mbylljes së veprimtarisë, sipas formularit të Shtojcës I. Autoriteti, bën çregjistrimin e tij nga regjistri, vetëm pasi verifikon plotësimin detyrimeve ligjore të ofruesit të shërbimeve postare.
- (2) Në çdo rast dhe për çfarëdo lloj shkakut ligjor, mbi të cilin ofruesi i shërbimit kërkon të bëjë mbylljen e aktivitetit, ai bart detyrimin të njoftojë Autoritetin, sipas parashikimit në pikën 1, të këtij neni.
- (3) Nëse të gjitha aktivitetet e shërbimeve postare do të mbyllën, pagesat vjetore do të llogariten bazuar në rregullimet ligjore, nënligjore dhe aktet rregullatore në fuqi, deri në ditën e njoftimit, sipas paragrafit 1) të këtij neni.

### **Neni 14**

#### **Përditësimi i Regjistrimit**

- (1) Ofruesit e shërbimeve postare që kanë bërë ndryshime në të dhënat e regjistrimit, detyrohen të njoftojnë Autoritetin, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga ndodhja e ndryshimeve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Rregullore.
- (2) Procedura që duhet të ndiqet është në përputhje me parashikimet e kësaj Rregullore dhe brenda afateve të përcaktuara.

### **Neni 15**

#### **Çregjistrimi**

- (1) Autoriteti, çregjistron një ofrues të shërbimeve postare nga regjistri, përveç rasteve të parapara me dispozitat e nenit 20, paragrafi 10) të Ligjit, edhe në rastet e shkeljeve të përsëritura të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, mosrespektimit të vendimeve të Autoritetit në përputhje me dispozitat e Ligjit, dhe aktet nënligjore dhe ato rregullatore.

## **KAPITULLI IV**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 16**

#### **Dispozitë kalimtare dhe përfundimtare,**



- (1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve postare, të cilët aktualisht ushtrojnë aktivitetin e tyre në shërbime postare dhe u janë lëshuar konfirmime të njoftimit, do të vazhdojnë aktivitetin e tyre në përputhje me detyrimet e specifikuara në këtë rregullore.
- (2) Ofruesit e shërbimeve postare, të cilët posedojnë licenca, janë të obliguar që brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të dorëzojnë formularin e njoftimit tek Autoriteti. Me këtë rast këta ndërmarrës nuk janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet e kërkuara si paraparë në pikën; **A 4, dhe 5, dhe pjesën B**, të formularit të njoftimit, me përjashtim të rasteve kur të dhënat janë ndryshuar nga koha kur është licencuar ndërmarrja, të cilat nuk janë të parapara me raportimet periodike.
- (3) Në rast se ofruesit e shërbimeve postare, të referuar në paragrafin 2) të këtij neni brenda afatit kohor të përcaktuar sipas paragrafit 2) të këtij neni, nuk dorëzojnë formularin e njoftimit, atëherë Autoriteti do të inicioj procedurat për revokimin e Licencave, të cilat i posedojnë këta ndërmarrës.
- (4) Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë ndërmarrësit, ofruesit e shërbimeve postare në trafikun postar kombëtar dhe ndërkombëtar, nëse nuk është rregulluar ndryshe në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.
- (5) Ofruesit e i shërbimit postar, duhet të marrin masa për të harmonizuar ofrimin e shërbimeve postare me dispozitat e kësaj rregulloreje, brenda afatit kohorë prej nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

### **Neni 17** **Hyrja në Fuqi**

- (1) Kjo Rregullore dhe Shtojcat e saj, hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Bordit Drejtues i Autoritetit, dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të Autoriteti.
- (2) **Shtojcat I, II dhe III**, janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Prishtinë, **xx, Prill, 2019**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

## FORMULARI 'NJOFTIM REGJISTRIMI' PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE

Formulari i njoftimit dhe deklarimit të të dhënave për ofrimin e shërbimeve postare nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, që ndërmarrësi duhet të plotësojnë dhe dërgojnë në Autoritet.

A. Informacione mbi ndërmarrësin që dërgon njoftimin		
1.	Të dhëna mbi ndërmarrësin	Plotësimet
1.1	Emri i Biznesit	
1.2	NRB - NRF	
1.3	Forma ligjore e biznesit (B. I. Sh.A; Sh.P.K. etj)	
1.4	Emri tregtar (nëse është i ndryshëm)	
1.5	Adresa,	
1.6	Qyteti, Kodi Postar	
1.7	Numri i telefonit	
1.8	E-mail adresa	
1.9	Ueb faqja Zyrtare	
<b>2.</b>	<b>Përfaqësuesi ligjor</b>	
2.1	Emri i Përfaqësuesit Ligjor	
2.2	Numri personal - ID :	
2.3	Autoriteti që e ka lëshuar	
2.4	Adresa, Kodi Postar	
2.5	Qyteti	
2.6	Numri i Telefonit	
2.7	E-mail adresa	
<b>3</b>	<b>Personi i kontaktit</b>	
3.1	Emri i personit të kontaktit	
3.2	Numri i telefonit fiks	
3.3	Numri i telefonit mobile	
3.4	Numri i telefonit i shërbimit / kujdesi për klientët	

4.	Fillimi/ndryshimi/mbyllja e veprimtarisë	
4.1	Fillimi	Data: ____ . ____ . ____
4.2	Ndryshimi	Data: ____ . ____ . ____
4.3	Mbyllja	Data: ____ . ____ . ____

5.	Dokumentet e bashkëngjitura për njoftimit	
5.1	Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit në ARBK.	
5.2	Kopje e certifikatës së numrit fiskal NRF, (Nëse është në certi. e RB, atëherë nuk ka nevojë)	
5.3	Kopje të letërnjoftimit, ID personit/ va fizik bartës të biznesit.	
5.4	Kopje e dokumentit informatë mbi biznesin (Plan i Biznesit).	
5.5	Përshkrimi i shkurtër i rrjetit dhe/ ose shërbimit/ eve postare që kërkon të ofrojë.	
5.6	Tarifat e parashikuara për ofrimin e shërbimeve postare.	

<b>B. Të dhëna mbi Shërbimet Postare që nuk bëjnë pjesë në Shërbimin Universal Postar</b>			
<b>Nr</b>	<b>Dërgesat postare, të dhënat për shërbimet</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Plotësime / sqarime</b>
<b>1.</b>	<b>Dërgesa të korrespondencës/ dokumente</b>		
1.1	Dokumente brenda vendit		
1.2	Dokumente jashtë vendit (eksport)		
1.3	Dokumente jashtë vendit (import)		
<b>2</b>	<b>Jo dokumente / Pako</b>		
2.1	Jo dokumente / Pako (eksport)		
2.2	Jo dokumente / Pako (import)		
<b>3.</b>	<b>Dërgesa të regjistruara</b>		
<b>4.</b>	<b>Dërgesa të siguruara</b>		
<b>5.</b>	<b>Dokumente biznesi</b>		
<b>6.</b>	<b>Libra</b>		
<b>7.</b>	<b>Katalogë</b>		
<b>8.</b>	<b>Gazeta</b>		
<b>9.</b>	<b>Revista</b>		
<b>10.</b>	<b>Mallra me ose pa vlerë tregtare</b>		
<b>11.</b>	<b>Të tjera (ju lutem specifikoni)</b>		
<b>12.</b>	<b>Zona e ofrimit të shërbimit</b>		
12.1	Nacional		
12.2	Ndërkombëtare		
<b>13.</b>	<b>Cilësia e shërbimit postar</b>		
13.1	Standardet e cilësisë së shërbimit		
13.2	Kufizimet e përmasave		
13.3	Kufizimet e peshës		
<b>14.</b>	<b>Marrëveshjet e qasjes ne rrjet</b>		
14.1	Të depozituara në pikën e qasjes		
14.2	Të grumbulluara nga vendi i dërguesit		

**Shënim:** Ky formular plotësohet i veçantë për çdo shërbim që nuk bën pjesë në shërbimin universal postar që kërkon të ofrojë ndërmarrja,

**DEKLARATA**

**Deklaroj nën përgjegjësinë personale:**

1. Nëpërmjet këtij dokumenti DEKLAROJ se dëshiroj të ushtroj aktivitetet e përmendura më lartë në fushën e shërbimit postar, dhe kërkoj regjistrimin në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare të administruar nga Autoriteti.
2. Nëpërmjet këtij dokumenti i paraqes Autoritetit, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, dhe/ose të gjithë dokumentet që sigurojnë se nënshkruesi i këtij 'Njoftim Regjistrimi', ka lidhje me personin përfaqësues të tij.
3. Deklaroj se informacionet që përmban ky 'Njoftim Regjistrimi', dhe çdo informacion tjetër i bashkëngjitur këtij dokumenti, është i saktë dhe i vërtetë dhe si ofrues i shërbimeve postare do të ofroj shërbimet postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, si të kërkuara në këtë 'Njoftim Regjistrimi', dhe të konfirmuara nga Autoriteti, dhe do të respektoj të gjitha detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 06/L-38 të datë; 21/12/2018; 'Për shërbimet postare', në Republikën e Kosovës, dhe Rregullorja për 'Autorizimin e Përgjithshëm' për ofrimin e shërbimeve postare.

Prishtinë, Datë; \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_.

**Përfaqësuesi ligjor**

\_\_\_\_\_  
(Vula, Nënshkrimi)

**Sqarime mbi dërgimin dhe/ose ndryshimin e të dhënave si dhe mbylljen e veprimtarisë,**

Këtu jep një përshkrim analitik të dërgimit të të dhënave dhe/ose ndryshimeve të deklaruara si dhe mbyllja e veprimtarisë për të cilat kryhet depozitimi i deklaratës të cilës i bashkëngjiten vetëm dokumente të domosdoshme për ndryshimet, apo të dhëna të tjera justifikuese. Në rast se nuk mjafton kjo faqe, bashkëngjitni faqe shtesë.

**CERTIFIKATË  
E KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT**

Nr.Prot. \_\_\_\_\_/ datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, konfirmon se ndërmarrësi; \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_ dhe numër Regjistrimi të Biznesit (NRB), \_\_\_\_\_, dhe Numër Fiskal (NRF), \_\_\_\_\_, ka paraqitur 'Njoftimin e Regjistrimit', sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 06/L-38, Për Shërbimet Postare, datë; 21/12/2018, në Republikën e Kosovës, dhe është regjistruar në 'Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Postare', për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, sipas regjimit të 'Autorizimit të Përgjithshëm'.

**A. Shërbimet Postare:**

1. Shërbime postare që ofrohen:

- a) .....
- b) .....
- c) .....
- d) .....

**B. Zona e ofrimit të shërbimeve postare:**

1. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të ofrojë shërbimet postare:

- a) Nacional (RKS) - \_\_\_\_\_;
- b) Ndërkombëtare - \_\_\_\_\_;
- c) Tjetër - \_\_\_\_\_.

Ofruesi i Shërbimeve Postare, i regjistruar për ofrimin e shërbimeve postare të mësipërme, i cili operon nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashikuara në Rregulloren e 'Autorizimit të Përgjithshëm' dhe dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-38, datë; 21/12/2018, 'Për Shërbimet Postare' në Republikën e Kosovës.

**Kryetari i Bordit**

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi & vula e Autoritetit)

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

### 1) Kërkesat e përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve postare që operojnë nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', janë të detyruar të bashkëpunojnë me Autoritetin, sa herë që i kërkohet sipas dispozitave të parapara të Ligjit dhe kësaj Rregullore, dhe në bazë të akteve të tjera të aplikueshme në fuqi.
2. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të depozitojnë në Autoritet, të dhënat statistikore dhe financiare të përditësuara sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuar me rregulloren përkatëse të nxjerrë nga Autoriteti, informacionet e kërkuara dhe hollësi të tjera lidhur me aktivitetet të cilat janë subjekt i regjimit të 'Autorizimit të Përgjithshëm' për ofrimin e shërbimeve postare.

### 2) Shërbimet postare Ekspres

1. Shërbimet postare ekspres, do të konsiderohen shërbime postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar. 'Shërbim Ekspres', është shërbimi i shpërndarjes 'derë më derë', në një kohë të shkurtër, përkatësisht shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë e caktuar të dërgesës postare që përfshin shpërndarjen e dërgesave dhe pakove postare.
2. Një shërbim postar do të konsiderohet si shërbim ekspres atëherë kur plotëson kërkesat e mëposhtme:
  - 2.1 Shpërndarja dhe dorëzimi standard i një dërgesë postare të postës së brendshme në rastin kur dërguesi dhe marrësi janë brenda territorit të Republikës së Kosovës, duhet të bëhet ditën tjetër të punës pas pranimit të dërgesës postare. Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuar kohën transite të dorëzimit sipas vendeve, përfshirë edhe kohën transite të dorëzimit në vendet ku dorëzimi nuk realizohet brenda ditës tjetër të punës. Koha standarde e dorëzimit e publikuar matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet të përcaktojë rastet e pamundësisë të dorëzimit të dërgesës postar brenda kohës së përcaktuar, të cilat i publikon në 'Termet dhe Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar'.
  - 2.2 Shpërndarja dhe dorëzimi i një dërgese postare në rastin kur dërguesi është jashtë territorit të Kosovës dhe marrësi brenda territorit të Republikës së Kosovës, duhet të bëhet brenda ditës tjetër të punës, pas mbërritjes së saj, në territorin e Republikës së Kosovës. Koha standarde e dorëzimit matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet të përcaktojë rastet e pamundësisë të dorëzimit të dërgesës postare brenda kohës të përcaktuar, të cilat i publikon në 'Termet dhe Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar'.

Ditët e pushimit javor si dhe ditët e pushimit të festave zyrtare sipas shteteve apo festave lokale në vendin e destinacionit apo origjinës nuk llogariten në kohën e dorëzimit.



- 2.3 Shërbimi postar është identifikuar në mënyre të qartë si shërbim postë-ekspres nga pranimi deri në dorëzim të dërgesës postare, i përfshirë në Termat dhe Kushtet e ofrimit të shërbimit postar.
- 2.4 Shërbimi ekspres përmban një kohë të para-caktuar të dorëzimit të dërgesës.
- 2.5 Shërbimi ekspres ndërkombëtar përmban një kohë të para-caktuar dhe të publikuar të dorëzimit sipas produktit apo llojit të shërbimit. Koha e dorëzimit duhet të jetë e publikuar dhe lehtësisht e qasshme për publikun në pikat e pranimit të dërgesave. Koha transit e dorëzimit matet me ditë pune sipas shteteve të destinacionit në rastin e eksportit apo shteteve të origjinës në rastin e importit. Koha standard e dorëzimit është për të gjitha rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar.
- 2.6 Lejimin e gjurmimit dhe ndjekjes elektronike të dërgesës postare nga përdoruesi i shërbimit 'end-to-end', si për dërgesat postare brenda vendit ashtu edhe për ato jashtë vendit. Gjurmimi duhet të jetë i plotë nga momenti i pranimit deri në momentin e dorëzimit, apo edhe rastet kur shërbimi për dërgesën postare konsiderohet i plotësuar.
- 2.7 Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe të qasshme lehtësisht për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të dërgesave postare, produktet dhe shërbimet standard të shërbimit ekspres, kohën e përcaktuar të dorëzimit si edhe çmimet përkatëse. Ofruesi i shërbimit postar ekspres, duhet të publikojë përshkrimin dhe pagesat (tarifat) përkatëse shtesë që bëhen mbi pagesat për çmimin e shërbimit standard ekspres të cilat janë të lidhura me karakteristika të veçanta të dërgesave postare që kërkojnë trajtim të veçantë administrativ dhe përpunues, shërbime për destinacione apo origjina të veçanta, si edhe pagesa për kosto shtesë të veçanta.
- 2.8 Shërbime të tjera me vlerë të shtuar mbi ato shërbime që përfshihen në shërbimin standard ekspres, duke përfshirë mundësinë e një çmimi **preferencial (premium)** sipas llojit të shërbimit me vlerë të shtuar.
- 2.9 Në qoftë se një ofrues i shërbimit postar është i mendimit se megjithëse shërbimi që dëshiron të ofrojë nuk përfshihet në përcaktimet e mësipërme të shërbimit postë ekspres, por ai mund të konsiderohet se nuk bën pjesë në shërbimin universal postar, mund të dërgojë argumentet e tij të detajuara në Autoriteti, për shqyrtim. Autoriteti bazuar në përcaktimet ligjore dhe ato rregullatore, shprehet në se ky shërbim është ose jo shërbim postë-ekspres.

### **3) Shërbimet postare me vlerë të shtuar**

1. Shërbimet ekspres me vlerë të shtuar janë ato shërbime të cilësuar si vlerë e shtuar për përdoruesin.
2. Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe lehtësisht i qasshëm për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të dërgesave postare, produktet dhe shërbimet me vlerë të shtuar të shërbimit ekspres si edhe çmimet përkatëse.
3. Shërbimet me vlerë të shtuar mund të përfshijnë një ose disa nga shërbimet e mëposhtme:

- 3.1 Dorëzim brenda një ore të ditës të përcaktuar dhe me garancion për 'Kthimin e Pagesës' në rast mosrealizimi sipas kushteve të përcaktuara, të tilla si; Përpara orës 9:00, Përpara orës 10:00, Përpara orës 12:00.
- 3.2 Tërheqje apo dorëzimi pas orarit. Shërbim i kërkuar jashtë orarit standart, jo të zakonshëm të punës.
- 3.3 Tërheqje apo dorëzim të dërgesave postare në ditët e pushimit.
- 3.4 Sigurimi i dërgesës postare. Sigurimi bëhet për një mbulim të plotë të vlerës në rast humbje apo dëmtimi të dërgesës postare sipas vlerës së deklaruar dhe kushteve të sigurimit të dërgesës postare.
- 3.5 Tërheqje apo dorëzim i specifikuar (veçantë), kur dërgesa postare ka specifika të caktuara dhe shërbimi normal nuk është i mjaftueshëm.
- 3.6 Paketimi i dërgesës. Paketim brenda kushteve standarde të paketimit nga ofruesit e shërbimit postar.
- 3.7 Administrimi i pagesës së detyrimeve të taksave dhe tatimeve nga ofruesi i shërbimit për lehtësi të dërguesit, apo një pale të tretë, kur sipas termave të realizimit të biznesit nuk i janë lenë marrësit për të paguar, apo në rastet kur marrësi për lehtësi administrimi ngarkon ofruesin e shërbimit për të paguar.
- 3.8 Konfirmimi i dorëzimit. Kur përdoruesi kërkon konfirmimit të dorëzimit të dërgesës me anë të firmojeses apo nënshkrimit, nga ofruesi i shërbimit, në mënyrë elektronike apo kopje të printuar si provë e dorëzimit të dërgesës në destinacion.
- 3.9 Trajtimi dhe transportimi i substancave dhe mallrave të klasifikuara si të rrezikshme në transportin ajror apo tokësor sipas përcaktimeve të organizatave botërore përkatëse.
- 3.10 Shërbime doganore apo administrim të shërbimeve dhe dokumentacionit doganor.
- 3.11 Garancion të dorëzimit të dërgesës postare në një datë të caktuar;
- 3.12 Dorëzimi i dërgesave postare 'personalisht', tek marrësit;
- 3.13 Mundësi për të ndryshuar adresën e destinacionit dhe rrugën që do të ndiqet për dorëzimin e dërgesës postare;
- 3.14 Shërbim i personalizuar për klientin.

#### **4) Respektimi i zonës së rezervuar**

1. Ofruesit e shërbimeve postare gjatë realizimit të veprimtarisë së tyre duhet të respektojnë zonën e rezervuar për ofrimin e shërbimeve postare me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 13, të Ligjit **deri në afatin e vlefshmërisë së tij.**

#### **5) Kërkesat për ofrimin e shërbimeve postare**

1. Kushtet për ofrimin e shërbimeve postare do të rregullohen në përputhje me Ligjin për shërbimet postare, këtë Rregullore dhe termat dhe kushtet e përgjithshme të përgatitura nga ofruesi i shërbimit postar.

#### **6) Kërkesat themelore për ofrimin e shërbimit postar**

1. Ofruesit e shërbimit postar, që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', janë të detyruar të përmbushin kërkesat themelore të përcaktuara sipas dispozitave të nenit 21, Ligjit, dhe në veçanti duhet të garantojnë:

- 1.1 Marrjen e veprimeve e nevojshme në lidhje me konfidencialitetin e dërgesës - korrespondencës, si dhe të përcaktojnë sipas legjislacionit në fuqi:
- a) Kërkesat/kushtet e paketimit të dërgesave postare (të përshtatshme për peshën, formën, llojin - natyrën e dërgesave, të thyeshme, materiale biologjike, radioaktive, të çmuara, etj.);
  - b) Të drejtat dhe detyrimet e organeve/personave që konform ligjit kanë të drejtë t'i hapin dërgesave postare në rastet:
    - i. Kur ato janë të dëmtuara në mënyrë të tillë që të ripaketoohen për t'u mbrojtur nga dëmtimi i mëtejshëm;
    - ii. Kur dyshohet për materiale apo substanca të ndaluara;
    - iii. Kur ka një urdhër të lëshuar nga organet kompetente.
- Hapja, shkatërrimi, dhe shpërndarja e këtyre dërgesave postare duhet të bëhet sipas rregullave/procedurave të përcaktuara nga ofruesi i shërbimeve postare dhe sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.2 Sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e funksioneve të rrjetit postar me qëllim funksionimin e tij edhe në situata të jashtëzakonshme;
- 1.3 Mos lejimin e dërgimit të dërgesave të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, ose për shkakë të natyrës së përmbajtjes ose ambalazhimi, mund të përbëjnë një dëm për njeriun, ambientin ose për pakot e tjera që janë për tu transportuar sipas rregullave të organizatave ndërkombëtare.
- 1.4 Ofruesi i shërbimit postar duhet të marrë masat për zbatimin e detyrimeve ligjore për sa i takon respektimit të kushteve të punësimit dhe orarin e punës në përputhje me parashikimet sipas Ligjit të Punës, në Republikën e Kosovës, respektimin e marrëveshjeve kolektive, mbrojtjen e të drejtave të punësuarve dhe/ose ligjet tjera të aplikueshme;
- 1.5 Ofruesi i shërbimit postar duhet të marrë masat për zbatimin e detyrimeve ligjore për sa i takon respektimit të kushteve të sigurimit shëndetësor të të punësuarve në përputhje me Ligjit për sigurinë në punë dhe shëndetin në punë, në Republikën e Kosovës;
- 1.6 Ofruesit e shërbimeve postare gjatë ofrimit të shërbimit duhet të kujdesen për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë së dërgesave, gjatë proceseve të përpunimit, komunikimit, transportimit apo përhapjes së këtyre të dhënave në forma të ndryshme, në përputhje me parashikimet e Ligjit për mbrojtje e të dhënave personale, në Republikën e Kosovës, dhe/ose ligjet tjera të aplikueshme;
- 1.7 Marrjen e masave të posaçme për mbrojtjen e ambientit - mjedisit, për sa i takon reduktimit të sasisë së mbeturinave dhe mundësia e riciklimit të tyre etj, kursimi dhe përdorimi me efikasitet të energjisë etj;
- 1.8 Në rastet kur kërkohet të ngrihet infrastruktura e posaçme, ngritja e ndërtesave apo instalimi i pajisjeve, ndërmarrësit apo sipërmarrësit janë të detyruar të marrin lejet dhe miratimet sipas rregullave dhe ligjeve të posaçme për këtë qëllim;

- 1.9 Ofruesi i shërbimit postar në rastin e situatave të jashtëzakonshme, vepron sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me situatë të jashtëzakonshme kuptohet dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës ose gjendjen e luftës.

## **7) Tarifat dhe ndarja e llogarive**

1. Tarifat e shërbimeve postare, përkatësisht tarifat për çdo shërbim që bënë pjesë në shërbimin postar duhet të përmbush parimet e mëposhtme:
  2. të jenë transparente dhe jodiskriminuese,
  3. të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit postar;
  4. të mos dëmtojnë konkurrencën.
5. Tarifat për shpërndarjen e dërgesave postare ndërkufitare, për dërgesat që vijnë nga jashtë vendit, përcaktohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumë palëshe midis ofruesit të shërbimit dhe ofruesve përkatës të shërbimeve postare ndërkufitare.
6. Ofruesi i shërbimit postar duhet të mbajë llogari të ndara për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e pagesës së mbikëqyrjes së tregut dhe identifikimin e treguesve të tjerë sipas kërkesave të Ligjit.

## **8) Termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare**

- (1) Ofruesit e shërbimeve postare, obligohen të hartojnë termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Termat dhe kushtet e përgjithshme duhet të përmbajnë informacionin e specifikuar në nenin 33, të Ligjit, si dhe standardet dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, rregullat e pranimit dhe dërgimit për përdoruesit e dërgesave postare dhe shpërndarjen e tyre nga ofruesit e shërbimeve postare.
- (2) Termat dhe kushtet e përgjithshme të hartuara nga ofruesit e shërbimeve postare, i dërgohen Autoriteti, për shqyrtim tridhjetë (30) ditë para aplikimit të tyre. Autoriteti, ka të drejtë të kërkojë apo imponojë ndryshimin e tyre nëse ato nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit, dhe këtë Rregullore.
- (3) Termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare publikohen në faqen zyrtare të internetit të ofruesve të shërbimeve postare. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të mbajnë kopje fizike në format të printuar dhe lehtësisht të lexueshëm të termave dhe kushteve të përgjithshmet ofrimit të shërbimeve postare në zyrat postare të tyre për t'i bërë të disponueshme për përdoruesin ose për t'i dërguar në adresën e përdoruesit postar nëse kjo kërkohet.

## **9) Rrjeti postar i ofruesit të shërbimit postar**

1. Pjesët përbërëse të rrjetit postar janë pikat e qasjes – zyrat postare, qendrat e përpunimit të dërgesave dhe elementët e tjerë në funksion të sigurimit të ofrimit të shërbimeve postare.

## 2. Pikat e qasjes të rrjetit postar:

- 2.1 zyrat postare;
  - 2.2 qendrat e përpunimit;
  - 2.3 pikat e vetë-shërbimit;
  - 2.4 kutitë postare, dhe
  - 2.5 pajisje dhe fasilite të tjera që shërbejnë për pranimin e dërgesave postare.
3. Ofruesi i shërbimit postar duhet të krijojë, mirëmbajë dhe zhvillojë një rrjet postar për të siguruar ofrimin e shërbimit postar në zonën e autorizuar në mënyrën e përcaktuar me Ligj dhe këtë Rregullore.
  4. Dendësia e pikave të qasjes dhe orari i punës së zyrave postare përcaktohet nga vetë ofruesi i shërbimit postar, duke përbushur kërkesat e Ligjit dhe në bazë të nevojave të përdoruesve të shërbimeve postare dhe kërkesave të bizneseve.
  5. Në rrjetin postar mund të vendosen vetëm pajisje të cilat kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë.

### 10) Standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimit postar

1. Ofrimi i shërbimeve postare duhet të realizohet në përputhje me standardet Evropiane dhe ato botërore për shërbimet postare, si dhe me standardet e përcaktuara nga Autoriteti në këtë Rregullore.
2. Standardet e cilësisë për shërbimin postar brenda vendit të ofruar nga ofruesi i shërbimit postar do të jenë:

#### 2.1 Standardet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – postë e shpejtë brenda vendit;

Objektivat e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – postë e shpejtë brenda vendit			
Brenda qytetit/Brenda Regjioni		Brenda Regjioneve tjera	
Koha e dorëzimit	Dërgesate postare të dorëzuara	Koha e dorëzimit	Dërgesat postare të dorëzuara
<b>D + 1</b>	<b>95 %</b>	<b>D + 2</b>	<b>4 %</b>

\* Shënime për tabelën në pikën 2.1:

Objektivat e mësipërm të cilësisë janë për dërgesat postare me kohë më të shpejtë shpërndarjes.

- **D**: dita e pranimin (depozitimit) të dërgesave postare nga ofruesi i shërbimit postar.
- **n**: numri i ditëve të punës (përfshihen ditët e pushimit dhe festave) që duhen për shpërndarjen e dërgesave nga data e pranimin deri në datën e dorëzimit.

2.2 Për dërgesat ekspres të postës ndërkufitare, mund të merren në konsideratë standardet e cilësisë të ofruesve të shërbimit postar me të cilët është lidhur marrëveshje.

3. Ofruesi i shërbimit postar, ka për detyrim të plotësimit të standardeve të mëposhtme të shërbimit postar të organizatës 'CEN', të transpozuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) në Republikën e Kosovës:

- 3.1 **SK - EN 13850:2007:** Shërbimi postar – Cilësia e shërbimit – Matja e kohës së tranzitit të shërbimeve nga fillimi në fund (end-to-end) për pjesë të veçanta të dërgimit prioritar me postë dhe dërgimi me postë i klasit të parë;
- 3.2 **SK - EN 14508:2007:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për një pjesë jo prioritare të dërgimit me postë dhe dërgimi me postë i klasit të dytë;
- 3.3 **SK - EN 14534:2007:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për dërgesat me postë me grumbuj të pa ambalazhuar.

## **11) Të drejtat e ofruesve të shërbimeve postare**

1. 'Autorizimi i Përgjithshëm', për ofrimin e shërbimeve postare, i jep të drejtë subjektit të autorizuar, për të ofruar shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', që nënkupton edhe të drejtën e qasjes në rrjetin postar të ofruesit të shërbimit universal, duke respektuar parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës, kurdoherë dhe kudo që të jetë e mundur.
2. Procedurat lidhur me kërkesën dhe dhënien e qasjes në rrjetin postar, përcaktohen me Rregulloren për ofrimin e shërbimit universal.

## **12) Transparenca dhe publikimi i informacioneve**

1. Ofruesi i shërbimit postar, publikon në faqen e tij të internetit informacionet që lidhen me shërbimin postar, që nuk bën pjesë në shërbimin universal sipas kërkesave të përcaktuara me Ligj, aktet rregullatore duke përfshirë dhe informacion në lidhje me:
  - 1.1 zyrat postare dhe oraret e tyre;
  - 1.2 tarifat dhe çmimet e shërbimeve;
  - 1.3 procedurat e trajtimit të ankesave (reklamimit) dhe të kompensimit (rimbursimit);
  - 1.4 modalitetet e qasjes në shërbime;
  - 1.5 standardet e cilësisë;
  - 1.6 qasjen për gjurmimin e dërgesave postare të brendshme dhe ndërkombëtare.

## **13) Pagesat**

1. Ofruesit e shërbimit postar, janë të detyruar të paguajnë në Autoritet, një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut postar, për të mbuluar kostot administrative të Autoritetit.
2. Niveli i pagesës për mbikëqyrjen e tregut të shërbimeve postare dhe kërkesat që duhet të plotësojnë ofruesit e shërbimeve postare për kryerjen e kësaj pagese, përcaktohen sipas dispozitave të nenit 28, të Ligjit dhe rregullave të nxjerra nga Autoriteti.

## **14) Ankesat**

1. Çdo ofrues i shërbimit postar është i detyruar të trajtojë kërkesat dhe ankesat e përdoruesve në lidhje me shërbimet postare që ofron. Nëse përdoruesi është i pakënaqur me përgjigjen apo



kërkesa aso ankesa nuk zgjidhen në mënyrë të drejtë nga ofruesi, brenda afateve ligjore, përdoruesi ka të drejtë të ankohet pranë Autoritetit.

2. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të publikojë, në faqen zyrtare të tij dhe në zyrat e ofrimit të shërbimit, rregullat për pranimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve, sipas nenit 35, dhe 46, të Ligjit, dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e përdoruesve - konsumatorëve.

#### **15) Mosmarrëveshjet**

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesit të shërbimit postar dhe përdoruesve, që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e ligjit dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij, zgjidhen nga Autoriteti sipas dispozitave të nenit 50, të Ligjit.
2. Mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar, zgjidhen nga Autoriteti sipas dispozitave të nenit 51, të Ligjit.

#### **16) Detyrime të tjera**

1. Ofruesit e shërbimit postar, konsiderohen përgjegjës për dëmet e shkaktuara pas pranimit të dërgesës, gjatë transportimit të dërgesave postare të regjistruara, të siguruar dhe pakove. Në rast të fajsit atëherë, duhet aplikuar dispozitat e nenit 47, të Ligjit.
2. Mallrat postare të cilat i nënrenditen procedurave doganore dhe mund të jenë subjekt i tarifës doganore, tatimeve apo taksave të tjera që paguhen në import apo eksport, apo mund të jenë subjekt i përjashtimit nga këto pagesa, aplikohen dispozitat e përcaktuara në Kapitullin XIII, të Ligjit dhe legjislacionit në fuqi.

#### **17) Mbikëqyrja dhe Inspektimi**

1. Për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së ofrimit të shërbimeve postare, dhe kushteve të përcaktuara nga Autoriteti, Autoriteti mbikëqyrë dhe inspekton veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve postare në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe aktet tjera në fuqi.
2. Nëse Autoriteti, evidenton se ofruesi i shërbimeve postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', nuk ushtron aktivitetin në përputhje me dispozitat e Ligjit, dhe rregulloret e nxjerra nga Autoriteti, termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Autorizim, Autoriteti, mund të ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme sipas dispozitave të parashikuara në nenin 58, të Ligjit dhe aktet tjera në fuqi.